





PS merr vendimin: Ornela Rakipi nuk përfshihet në përgjegjësi të asgjë. Njëri nga të dytë të bashkëpunëtorin e saj.




Urdhëroi pengmarrijen e shokut sepse i kishte para borxh, lëshoi burg 37-vjeçarja në Tiranë! Doli me pizhame në gjykatë! Burg edhe për bashkëpunëtorin e saj.



Komisioni me tenderat GJKKO nis gjyqin ndaj Fatos Tushes dhe 21 të tjerëve. Lushnjë kërkoi gjykim të shpejtë.



Ankrohet anija turke në portin e Durrësit, shtoi përfaqësimin për Kosovën.




PS i ftu në negociatat për emrin e Presidentit. Mësoi: Qësoria të negociatave si një trupë e vetme! Altheu: Do konsultohem me grupin parlamentar, të mos e zgjidhet me shumicë të thjeshtë.

Ishte në kërkim, por grabiti me armë pikën e postës në Kamëz, i riu i shpëton sërish policisë! Arrestohet shoku i tij: S'kam marrë asnjë lekë, qendrova jashtë kur Elisi hyri të vidhte

Algert Kurti, 20 vjeç është arrestuar nga policia pas grabitjes me armë të pikës së Postës Shqiptare në një ditë me parë në Kamëz, ndërsa është shpallur në kërkim bashkëautorit tjetër Elis Suçi, 30-vjeç. Elis Suçi, i dënuar më parë për vjedhje, ishte në kërkim, pasi në muajin Mars qëlloi me armë në drejtim të policisë në afërsi të shkollës në Kamëz, teksa këto të fundit po shkonin që ta arrestonin.

■ Grabiti postën në Kamëz, Report Tv siguron foton e të kërkuarit, Elis Suçi, me maskë COVID dhe kapele




Redaksia 19 Prill, 08:55 | Përditësimi i fundit: 19 Prill, 13:17



TIRANË- Megjithëse ishte në kërkim nga policia për vjedhje, kjo nuk e ka penguar 30-vjeçarin Elis Suçin, që të shkojë dhe të grabisë nën kërcënimin e armës pikën e postës Shqiptare në Kamëz. Policia thotë se ka **zbardhur ngjarjen** e ndodhur një ditë më parë dhe ka shpallur në kërkim 30-vjeçarin, i cili dhe këtë herë ka mundur që të arratiset, ndërsa ka arrestuar shokun e tij, bashkëautor në vjedhje Algert Kurtin 20-vjeç.

Të dy në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të maskuar, grabitën nën kërcënimin e armës dje në mesditë, fillimin e postës Shqiptare në Kamëz, ku morën 100 mijë lekë dhe u larguan. Policia ka sekuestruar një aparat celular dhe veshje, të cilat autorët dyshohet se i kanë përdorur gjatë kryerjes së krimit.



LEXO EDHE: **Ishte kreu i PD Kamëz sulmon zgjedhjet e Berishës: Janë farse, votuan simpatizantë të LSI, jo demokratët, vendosi në krye një përfaqësues të Rakip Sulit**

Elis Suçi, i dënuar më parë për vjedhje, ishte në kërkim, pasi në muajin mars qëlloi me armë në drejtim të policisë në afërsi të shkollës në Kamëz, teksa këto të fundit po shkonin që ta arrestonin.

Ndërkohë në dëshminë e tij, 20-vjeçari Algert Kurti, ka mohuar që të ketë marrë pjesë në vjedhje, ndërsa shton se vetëm ka pasur dijeni për grabitjen. Ai ka thënë para hetuesve se nuk e ka takuar Elisin pas grabitjes, dhe se nuk ka marrë asnjë lekë. I riu mësohet të ketë thënë se ai ka qendruar jashtë gjatë grabitjes.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 12:25

U arrestua për grabitjen e postës, zbardhet dëshmia Algert Kurtit: S'kam marrë asnjë lekë, Elisi e ka kryer vjedhjen, unë qendrova jashtë

Report Tv zbarch dëshminë e Algert Kurtit, i arrestuar si bashkëpunëtor në grabitjen e Postës Shqiptare në Kamëz. Kurti përjashton veten nga grabitja, edhe pse pranon se ka qenë në dijeni se Suçi do të bënte grabitje: "Po qendroja para gjimnazit të Kamëzës. Elisin e gjeta aty tek posta dhe kishte vëzhguar levizjet e punonjësve të postës. Kur shkova ta takoj me tha që do grabisim postën. Unë nuk kam marrë lekë, dhe ku Elisi ka hyrë brenda për të kryer grabitjen unë po prisja jashtë. Kemi qenë në këmbë jo në makinë. Në momentin që Elisi ka dalë jashtë, kalova në krahun tjetër të rrugës nga ana e gjimnazit. Më vonë kam shkuar në Institut për të lënë një porosi tek një mik i mi. Nuk kam takuar më me Elisin dhe nuk kam folur me të. Thjesht kam pasur dijeni për këtë ngjarje", tha Kurti para hetuesve.



Ora 12:11

Grabiti postën në Kamëz, Report Tv siguron foton e të kërkuarit, Elis Suçi, me maskë COVID dhe kapele

Report Tv ka siguruar foton e Elis Suçit, i shpallur në kërkim për vjedhjen e pikës së Postës në Kamëz një ditë më parë, ndërsa është shpallur në kërkim nga policia. Suçi shfaqet me maskë anti-Covid dhe me një kapele në kokë.



M.Q./Shqiptarja.com

TAG: grabitje, algert kurti, elis suçi, tirane, kamëz

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

A mendoni se presidenti i ri do të zgjidhet me konsensus?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë



Urdhëroi pengmarrijen e shokut sepse i kishte para borxh, lëshoi burg 37-vjeçarja në Tiranë! Doli me pizhame në gjykatë! Burg edhe për bashkëpunëtorin e saj.

19 Prill, 11:31

Kronikë



Për herë të parë në Shqipëri, shoferët i nënshtrohen testit të drogës! Arrestohet 25-vjeçarit, i hiqet patenta dhe gjyqit me 15 mijë lekë.

19 Prill, 10:04

Kronikë



Grabitje pika e Postës Shqiptare në Kamëz! Autori përdori një armë lodër dhe mori 100 mijë lekë.

18 Prill, 14:46


Kronikë



Policia rrugore kontrollon të shtuar, rreth 900 gjopa në ditë në Tiranë për shoferët problematikë, ja shikojtë më të shpeshta që kryejnë.

18 Prill, 12:56

Sociale



Bulevard i ri për njësitë 1 dhe 2, transformohet zona e ish-tregut Elektrik, Velaj: Rritet vlera e pronës, investime në urbanizim dhe hapësira për fëmijët.

18 Prill, 12:31

Kronikë



VIDEO /Ku shkon me këto, këto janë false, si e kapi punonjësja e 'Exchange' të riut! Iku me vrap sa pa që shitësjja mori telefonin! Pranga 3 të rinjve.

18 Prill, 11:26

Politikë



FOTO/ Procesi i rindërtimit pas tërmetit, drejt përfundimit banesat për 74 familje në Ndroq.

18 Prill, 09:12

Sociale



Kryebashkiaku Velaj uron Pashkët: Së shpejti një shtatore e Nënë Terezës në Parkun e Ligenit, si një vend lutjeje e reflektimi.

17 Prill, 14:00

Kronikë



Kanosi me thikë 2 motrat dhe babain, arrestohet 30-vjeçari në Tiranë.

17 Prill, 13:41

Sociale



Sot devijohet lëvizja e automjeteve në Unazën e Madhe, ja si do të bëhet qarkullimi i mjeteve.

17 Prill, 09:53

Kronikë



VIDEO /'Si cjapi të kasapi', kryen parakalim të gabuar por përballë kishte policinë! Shoferi i papërgjegjshëm e pëson në rrugën Tiranë-Rinas.

17 Prill, 09:38

Kronikë



EKSKLUZIVE/ Zbulohet baza në Tiranë, kodonin celularë të pagjumëshëm, përdoren nga trafikanti! Sekuestrohet serveri, filmohen disa prej klientëve.

16 Prill, 17:26

Arsen Rusta